



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA MALLAKASTËR**  
**KRYETARI**

Nr. \_\_\_\_\_ Regj.  
2018

Ballsh, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .

Lënda: **Dërgohet për publikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe Buletinin e Njoftimeve Publike, Formulari i Njoftimit të Fituesit**

**AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK - TIRANË**

për ngarkim në sistemin e prokurimit elektronik të APP, në adresën [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

**BASHKIA MALLAKASTËR**

Data 21.11.2018

Për: **Operatorin Ekonomik "FLED" shpk, me NIPT K17621104C, me adresë Lagja "Havaleas", Rruga Ura e Kozares, Kuçovë.**

\*\*\*

Procedura e prokurimit: **"Kërkesë për propozim"**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-91317-10-24-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **"Rikonstruksion godina e MNZ"**, me fond limit **4.166.667** (katërmilion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) **lekë pa TVSH**, me afat 2 muaj nga lidhja e kontratës.

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike nr.43, datë 29 tetor 2018

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **çmimi më i ulët X** oferta ekonomikisht më e favorshme

**Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:**

1. Operatori Ekonomik "B-93" shpk, me NIPT J62903508R, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën 3.844.566 (tremilion e tetëqind e dyzet e katërmijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.
2. Operatori Ekonomik "ELDA-VL" shpk, me NIPT K67106202W, nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.
3. Operatori Ekonomik "FLED" shpk, me NIPT K17621104C, ka paraqitur ofertën ekonomike



në shumën 3.929.994 (tremilion e nëntëqind njëzetë e nëntëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

4. Operatori Ekonomik “SHENDELLI” shpk, me NIPT K07924803N, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën 4.009.609 (katërmilion e nëntëmijë e gjashtëqind e nëntë) lekë pa TVSH.

### **Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:**

#### **1. Operatori Ekonomik “B-93” shpk, për arsyet e mëposhtme:**

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “k”, të pikës 2.3. “Për kapacitetin teknik”, të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 11 të dokumentave standarte të tenderit. Kërkesa e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor në shkronjën “k”, të pikës 2.3. është: *“Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të tij 2 (dy) Manovrator Dëshmi e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë dhe të figurojnë në listëpagesa. Për manovratorët operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratat e punës dhe policat e sigurimit të aksidenteve personale.”*. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE “B-93” shpk, rezulton se nuk janë paraqitur policat e sigurimit të aksidenteve personale për 2 manovratorët e kërkuar si pjesë e stafit. Në nenin 53, pika 3, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, theksohet që: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*.

#### **2. Operatori Ekonomik “ELDA-VL” shpk, për arsyet e mëposhtme:**

- Nuk plotëson asnjë prej kërkesave të kualifikimit, sipas përcaktimeve të bëra në dokumentat e tenderit, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për plotësimin e tyre. Ky operator nuk ka paraqitur as ofertë ekonomike.

#### **3. Operatori Ekonomik “SHENDELLI” shpk, për arsyet e mëposhtme:**

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “k”, të pikës 2.3. “Për kapacitetin teknik”, të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 11 të dokumentave standarte të tenderit. Kërkesa e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor në shkronjën “k”, të pikës 2.3. është: *“Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të tij 2 (dy) Manovrator Dëshmi e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë dhe të figurojnë në listëpagesa. Për manovratorët operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratat e punës dhe policat e sigurimit të aksidenteve personale.”*. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE “SHENDELLI” shpk, rezulton se nuk janë paraqitur policat e sigurimit të aksidenteve personale për 2 manovratorët e kërkuar si pjesë e stafit. Në nenin 53, pika 3, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, theksohet që: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*.

\* \* \*



Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik **"FLED" shpk, me NIPT K17621104C, me adresë Lagjja "Havaleas", Rruga Ura e Kozares, Kuçovë,** se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **3.929.994** (tremilion e nëntëqind njëzetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër) **lekë pa TVSH,** është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Mallakastër lagjia "18 Prilli", Ballsh, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 13.11.2018

Ankesa: Për këtë procedurë prokurimi nuk ka patur ankesa.

## TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

**Agron Kapllanaj**

